

REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1233-1 / 22

Nr. i fq. / Br. st - 38 -

Data: / Datum 29.09.2022

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari i Komunës



RAPORT

**PËR SITUATËN EKONOMIKE FINANCIARE DHE ZBATIMIN E PLANEVE
INVESTUESE PËR GJASHTËMUJORIN E PARË 2022**

Shtator, 2022

Në raportin për situatën ekonomike financiare, realizimin e planeve investuese, për gjashtëmujorin e parë 2022 është paraqitur puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës, përkatësisht ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave, përgjegjësi të tyre të përcaktuara me ligj, akte nënligjore, Statutin e komunës, si dhe planin punës së Kryetarit – ekzekutivit të komunës. Në raport është paraqitur e gjithë punën e cila është bërë në të gjitha fushat përmes drejtorive, përkatësisht sektorëve në kuadër të administratës komunale duke përfshirë edhe fushën e arsimit shëndetësisë etj.

Që në fillim të mandatit si qeveri komunale, kemi has në vështirësi sa i përket fillimit të implementimit të buxhetit, më saktësisht kryerjes së pagesave për shkak të mosmiratimit me kohë të buxhetit të komunës. Siç dihet buxheti i komunës është miratuar në kuvend më 31 janar 2022, ndërsa në sistem nuk ka dalë deri më 15 maj 2022. Këto vonesa janë reflektuar gjithashtu në fillimin e realizimit të projekteve kapitale. Problem tjetër në ekzekutimin e projekteve ka qenë dhe është edhe implementimi i projekteve dy dhe trivjeçare për faktin se kontratat janë lidhur me çmime të tregut, ndërsa me ngritjen enorme të çmimeve në këtë vit të derivateve të naftës, materialit ndërtimor energjisë etj. operatorët ekonomik kanë hasë në vështirësi financiare ku kemi pasë ankesa dhe kërkesa te autoriteti kontraktues për t'i marrë në konsideratë këto probleme. Te këto raste kemi ardhë në situatë ku kemi qenë të detyruar që projektet të ritenderohen duke rritë vlerën e projektit dmth. të ndahen mjete shtesë për projekte të njëjta siç ka qenë rasti me projektet “furnizimi me makineri bujqësore”, “asfaltimet e rrugëve lokale”, “ndërtimi i kanalizimeve, shesheve” etj. E gjithë kjo ka ndikuar negativisht në realizimin e buxhetit në këtë gjashtëmujor. Këto pasoja do t'i kemi edhe pas gjashtëmujorit, por që do të mundohemi që deri në fund të vitit t'i zgjedhim për aq sa do të kemi mundësi dhe t'na lejojnë aspektet ligjore.

BUXHET DHE FINANCA

Meqenëse buxheti për vitin 2022-2024 është aprovuar më 31.1.2022, gjatë janarit kemi punuar në hartimin e planit të buxhetit 2022-2024 sipas specifikave të veçanta në sistemin BDMS (Sistemi i zhvillimit të menaxhimit të buxhetit). Me përfundimin e vitit fiskal 2021 kemi filluar përgatitjet për fillimin e vitit fiskal 2022, duke evidentuar së pari obligimet e papaguara nga viti i kaluar.

-Kemi bërë barazimet me sistemin e free balancit dhe kemi hartuar pasqyrat financiare për vitin fiskal 2021. --Kemi përgatit dokumentacionin e nevojshëm për fillimin e vitit fiskal 2022 dhe kemi caktuar me kohë personat -përgjegjës për autorizimin e shpenzimeve dhe personat përgjegjës që punojnë në sistemin e free balancit (Sistem për menaxhimin financiar dhe kontroll) sipas rregullave të Ministrisë së Financave. Kemi bërë bartjen e të hyrave të pashpenzuara nga viti 2021 që kanë qenë në shumë prej 2,574,011.71. Më datë 3.2.2022 kemi filluar me pagesa, por buxheti i lejuar ka qenë 1/12 e vitit 2021 për çdo muaj deri më datë 15 maj 2022 kur edhe ka dalë buxheti në sistem nga Ministria e Financave për inicimin, realizimin e kërkesave dhe planeve buxhetore 2022, i cili na penguar mjaftueshëm për realizimin e planeve në afatet kohore të planifikuara.

-Kemi pranuar 982 fatura deri më sot, ato janë dorëzuar në prokurim dhe te personat tjerë përgjegjës për kompletim lënde për pagesë.

- Zyrtari i të hyrave bën barazimet me Ministrinë e Financave në baza mujore.
- Drejtoria për buxhet dhe financa bënë inkasimin e pjesës më të madhe të të hyrave komunale, kurse deri më 30 qershor janë mbledhur gjithsej 1,328,226.26 euro.
- Nga tatimi në pronë dhe në tokë të planifikuar kanë 1,059,669.00 € për vitin 2022, kurse janë realizuar të hyra 461,762.91 €.

-Në baza tremujore bëhet barazimi i të hyrave dhe shpenzimeve me sistemin e free balancit, si dhe raportimi.

- Në muajin prill kemi bërë raportimin në kuvend për tremujorin e parë për të hyrat dhe shpenzimet.
- Në majin maj kemi marrë Qarkoren buxhetore 01/2023 nga MF me kufijtë e caktuar dhe së bashku me të gjitha drejtoritë kemi harmonizuar kërkesat për vitin 2023.
- Në muajin qershor e kemi dorëzuar në K.K Kornizën afatmesme të buxhetit për vitet 2023-2025, si dhe jemi në proces të planifikimit të buxhetit 2023-2025.

Meqenëse se Drejtoria për Buxhet dhe Financa kryen shërbime për të gjitha drejtoritë tjera sa i përket planifikimit dhe realizimit të buxhetit, ne po e paraqesim në vija të trasha planifikimin dhe realizimin e buxhetit, kurse për shënime analitike është raporti vjetor i të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe pasqyrat financiare që do të paraqiten në Kuvendin komunal pas auditimit nga ana e auditorit të përgjithshëm.

Sqarim: Shumat e prezantuara janë sipas raportit financiar të Sistemit për menaxhimin financiar dhe kontroll

Planifikimi i buxhetit për vitin 2022 është si në vijim

- Paga dhe mëditje..... 10,811,462.95 €
- Mallra dhe shërbime..... 3,955,236.98 €
- Shpenzime komunale..... 442,504.93 €
- Subvencione dhe transfere..... 1,365,940.00 €
- Investime kapitale..... 6,042,316.42 €
- Rezervat5,000.00 €

Totali..... 22,622,461.28 €

Forma tabelare: Buxheti i planifikuar dhe shpenzimet e realizuara

Përshkrimi	Kodi	Buxheti i planifikuar	Shpenzimet e realizuara	Përqindja e buxhetit të realizuar
		4	5	$6 = 5/4 * 100$
		€	€	%
Paga dhe mëditje	111	10,811,462.95	5,013,904.34	46.38
Mallra dhe shërbime	130	3,955,236.98	1,130,456.41	28.58
Shpenzime komunale	132	442,504.93	222,142.11	50.20

Subvencionet dhe transferet	200	1,365,940.00	246,875.58	18.07
Investimet kapitale	300	6,042,316.42	146,926.19	2.43
Rezervat		5,000.00	0.00	0.00
TOTALI		22,622,461.28	6,760,304.63	29.88

EKONOMI, BUJQËSI, PYLLTARI

Sektori i bizneseve

Biznese të reja të regjistruara 118 Sh.p.k,
 Biznese të reja të regjistruara individuale 65 B.I,
 Biznese të shuara 38,
 Ndryshime 98,
 Ndryshime në logo dhe ndërrim të certifikatave 116.
 Vërtetime 7.
 Gjithsej 442 lëndë të punuara gjatë periudhës janar-qershor 2022.

Sektori i bujqësisë

Gjatë këtij viti **janar – qershor 2022** në sektorin e bujqësisë janë zhvilluar një numër i aktiviteteve të bazuara kryesisht në planin e punës për vitin **2022**.

1. Projekti në bashkëfinansim me organizatën IADK - “Fuqizimi i të rinjve dhe grave të zonave rurale për përfshirje në bujqësi dhe përpunim të ushqimit”;

Ky projekt është në fazën e përfundimit, ku janë 9 përfituese:

- Serra, sipërfaqe prej 1 ari për 2 përfituese.
- Pajisje për bletari 3 përfituese.
- Pajisje për blegtori 4 përfitues.
- Përpunimi i pemëve dhe perimeve.
- Përpunimi i qumështit.

2. Projekti: Furnizimi me makina për shkokëlimin e misrit është në përfundim

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Makina për shkokëlimin e misrit	18	18x100= 1800.00€	14,220.00€	16,020.00€

3. Projekti: Furnizimi me frezë për traktorë, është në proces të kontraktimit

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Frezë për traktorë	36	200x36=7200€	36,000.00 €	43,200.00€

4. Projekti: Furnizimi me motokultivatorë, është në proces të kontraktimit

Nr.	Lloji i investimit	Nr.i përfituesve	Participimi	Komuna	Shuma
1	Motokultivatorë	50	150x50=7500€	42,500.00€	50,000.00€

4. Projekti për pastrimin e kanaleve kulluese në Studime-Maxhunaj-Dumnicë e Llugës në vlerë prej 24,649.00€ është përmbyllur derisa pastrimi i kanaleve kulluese Lumadh - Dumnicë e Poshtme në vlerë prej 18,682.39 është në përfundim e sipër.

5. Vlerësimi i dëmeve të shkaktura nga fatkeqësitë natyrore.

Gjatë reshjeve dhe stuhisë përcjellë me breshër, gjatë muajit qershor janë shkaktuar dëme të konsiderueshme edhe në bujqësi. Në kuadër të komisionit komunal për vlerësim të dëmeve, përfaqësuesit e Drejtorisë së bujqësisë kanë qenë bartës të vlerësimeve në lëmin e bujqësisë dhe janë vlerësuar dëmet në 22 ekonomi bujqësore. Raportet me vlerësimet e dëmeve të vërtetuara nga komisioni do t'i përcillen Ministrisë së Bujqësisë për kompensim të dëmeve.

Gjatë vitit 2022 është bërë edhe aplikimi i fermerëve të komunës tonë për pagesa direkte (subvencioneve) në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, ku kanë aplikuar gjithsej 1543 fermerë për kulturat bujqësore, të cilat janë në program, si dhe për kategoritë tjera si lopë qumështore, litër qumësht, buallica, dele, dhi, derra, pula.

Sektori i pylltarisë

Nr.	Përshkrime	Vendi	Prill	Gjithsej janar-korrik
1	Kërkesa për leje	Pran zyrës	0	25
2	Kërkesa të kryera	ZK-APK-Mitrovicë	0 m ³	6=280.12 m ³
3	Damkosje dru zjarri	ZK-APK-Mitrovicë	0 m ³	280.12 m ³
4	Fl-përcjellje p-private	Sektori i pylltarisë	3flp=7.00 m ³	11=25.50 m ³
5	Fl- përcjellje p-shtetërore	Sektori i pylltarisë	0m ³	0 m ³
6	Fl-pagesa p-private	Sektori i pylltarisë	1=67.50€	6=518.10€
7	Konfiskimet	Sektori-policia	1=2.20 m ³	3=7.50 m ³
8	Gjendja në depo	Pranë sektorit	103.40 m ³	103.40 m ³
9	Zjarre	Në terrene private	40ha	65.30ha
10	Fl-paraqitje k-vajtje	Sektori-gjykata	0€	29=48.97 m ³ =6917.02€
11	Fl. paraqitje penale	Sektori-prokurori	0€	6=15.55 m ³ =2343.65€
12	Gjithsej Fl-paraqitje K-vajtje dhe penale	Sektori-gjykata – Prokurori	0€	35=64.52m ³ =9260.97€
13	Kontrolle në terren	Sektori-policia	18	59

Janë iniciuar 29 kërkesa për inicim të procedurës për kundërvajtje, si dhe janë paraqitur 6 kallëzime penale në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

PROKURIMI PUBLIK

I tërë aktiviteti i prokurimit i realizuar është bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237 i cili ka hyrë në fuqi dhe ka filluar së zbatuari më dt. 5 tetor 2011, Ligjin Nr. 05/L-068 i cili ka hyrë në fuqi dhe ka filluar së zbatuari më dt. 21.1.2016, Ligjin Nr. 05/L-092 i cili ka hyrë në fuqi dhe ka filluar së zbatuari më dt. 1.3.2016, duke zëvendësuar kështu Ligjin e Prokurimit Publik në Kosovë, nr. 03/L-241, si dhe rregullat dhe udhëzuesin operativ për prokurimin publik.

Në periudhën raportuese, drejtoria konform dispozitave ligjore që rregullojnë lëmin e prokurimit, ka iniciuar dhe realizuar 93 prokurime për t'i realizuar dhe përmbushur kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të autoritetit kontraktues.

Në vazhdim janë paraqitur të dhënat lidhur me planifikimin e prokurimeve për vitin 2022

II.1) KONTRATAT PËR FURNIZIM

	Përshkrimi i kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
1	Furnizim me pajisje të TI-së për sallën e testimit për rekrutim	PO
2	Furnizim me inventar për QKMF-të	Në proces të prokurimit
3	Furnizim me inventar për shkolla	Jo - Ka kontratë nga Agjencia Qendrore e Prokurimit
4	Furnizim me inventar	JO
5	Furnizimi dhe montimi i motorit për gjenerator të administratës komunale	Në procedurë të prokurimit
6	Furnizimi dhe montimi i kalldave dhe paisjeve tjera për ngrohje	Jo
7	Furnizimi dhe montimi i kaldave për ngrohjet SHMT "Lutfi Musiqi" dhe në SHMU-II	Jo
8	Furnizim me kurora, lule për homazhe dhe buqeta me lule	Në proces të prokurimit
9	Furnizim me pajisje për lavanteri	Po (nuk ka pasur sukses për shkak se nuk ka pasur oferta)
10	Furnizim me pajisje mjekësore	Në procedurë të prokurimit
11	Furnizim me gjeneratorë	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
12	Furnizimi dhe montimi i kamerave në rr. "Dëshmorët e kombit", shkolla, SHR dhe QMF AMF-të në fshatra	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
13	Furnizim me material shpenzues për zyra	Po
14	Furnizim me enë për kuzhinë	Jo
15	Furnizim me stufa për ngrohje	Jo
16	Furnizim me bombola të oksigjenit mjekësor	Po
17	Furnizim me filma të rëntgenit (RTG-së)	PO
18	Furnizim me barna dhe material shpenzues shëndetësor	Po
19	Furnizim me reagensa dhe material shpenzues për laborator	Po

20	Furnizim me material higjenik	PO
21	Furnizimi dhe montimi i kablllos optike	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
22	Furnizim me goma për automjetin e zjarrfikësve	PO
23	Furnizim me pajisje dhe mjete për zjarrëfikje	Në procedurë të prokurimit
24	Furnizim me pemë dhe perime	PO
25	Furnizim me pajisje për kabinetin e teknologjisë ushqimore	Në proces të prokurimit
26	Furnizim me pajisje për kabinetin e metalurgjisë	Në proces të prokurimit
27	Furnizim me pajisje për praktikë profesionale	Në proces të prokurimit
28	Furnizim me pajisje për praktikë profesionale për SHMP “Bahri Haxha”	Në proces të prokurimit
29	Furnizim me pajisje laboratorike për SHMP “Bahri Haxha”	Në proces të prokurimit
30	Furnizim me drunj dekorativ për oborret e shkollave	PO
31	Furnizim me material pedagogjik	Në procedurë të prokurimit
32	Furnizim me aparate kundër zjarrit	Në procedurë të prokurimit
33	Furnizim me makina për kositjen e barit	PO
34	Furnizimi dhe montimi i ulseve për nxënës dhe shportave për mbeturina në oborret e shkollave	JO
35	Furnizim me topa, rekuizita dhe mjete tjera sportive	Në procedurë të prokurimit
36	Furnizim me projektor dhe mbajtëse për projektor	Në procedurë të prokurimit
37	Furnizim me TV për shkolla	Në procedurë të prokurimit
38	Furnizim me gaz natyror për kuzhinë	Po
39	Furnizim me flamuj për nevojat e AK.-Vushtrri	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
40	Furnizim me pajisje elektrike për amvisëri	Në procedurë të prokurimit
41	Furnizim me perde dhe tepiha	Në procedurë të prokurimit
42	Furnizim me lodra për fëmijë	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
43	Furnizim me produkte tekstili (çarçaf, batanije, jastak, tepih)	Në proces të prokurimit
44	Furnizim me mjete konkretizimi	Në procedurë të prokurimit
45	Furnizim me teknologji informative	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
46	Furnizim me aparate fotokopjuese	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
47	Furnizimi dhe montimi i klimave	Në procedurë të prokurimit

48	Furnizimi dhe montimi i kaldas elektrike në QMF Lumadh	Në proces të prokurimit
49	Furnizim me diktafon	Në procedurë të prokurimit
50	Furnizim me notesa dhe kalendarë	JO
51	Furnizim me preparate kimike	PO
52	Furnizim me veshmbathje	Në proces të prokurimit
53	Furnizim me lëndë djegëse - pelet për ngrohje	Në procedurë të prokurimit
54	Furnizim me materiale për festat e fundvitit	JO
55	Furnizim me lëndë djegëse - dru për ngrohje	Në procedurë të prokurimit
56	Furnizim me libra për bibliotekën e qytetit dhe të shkollave	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
57	Furnizimi dhe montimi i xhamave në objektet shkollore, shëndetësore dhe të administratës	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
58	Furnizim me aparaturë për kinema për funksionalizim në qendrën e kulturës	Në proces të prokurimit
59	Digjitalizimi i pultit dhe ndriçimit profesional për teatrin “Hasan Prishtina”	Në proces të prokurimit
60	Furnizim me aparat të oksigjenit për rezidentë	Në procedurë të prokurimit
61	Furnizim me kupa dhe medalje për aktivitete kulturore dhe sportive	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
62	Furnizim me bari për oborre të shkollave	PO
63	Furnizim me pajisje të TI-së për SHMP “Bahri Haxha”	PO
64	Inventarizimi i qendrës së kulturës	PO
65	Furnizim dhe montim i kuzhinës në DBTHF	PO
66	Furnizim me material për radiologji	PO
67	Furnizim me impute dhe farëra tjera për mbyllje pranverore	PO
68	Furnizimi me pajisje (materialeve) sportive për DKRS	PO
69	Furnizim me pompë uji për SHFMU “Jusuf Gërvalla”	PO
70	Furnizim me dekorata për ndarjen e titullit Qytetar nderi	PO

II. 2) Kontratat për Shërbime

	Përshkrimi i kontratës	Projekti është realizuar PO / JO
1	Shërbime të arsimit dhe trajnimit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
2	Servisimi dhe mirëmbajtja e ngrohjeve qendrore	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
3	Mirëmbajtja e ndriçimit public	Në procedurë të prokurimit
4	Mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertikal	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
5	Mirëmbajtja e serverit të sistemit të menaxhimit të mbeturinave	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
6	Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
7	Shërbime hoteliere	Në procedurë të prokurimit
8	Sigurimi i automjeteve	PO
9	Kontrollimi teknik i automjeteve	PO
10	Servisimi dhe mirëmbajtja e gjeneratorëve	Në proces të prokurimit
11	Servisimi dhe mirëmbajtja e TI-së	Në proces të prokurimit
12	Servisimi dhe mbushja e aparateve kundër zjarrit	Në proces të prokurimit
13	Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të komunikimit	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
14	Servisimi dhe mirëmbajtja e aparateve të rëntgenit dhe pajisjeve përcjellëse	Në proces të prokurimit
15	Pastrimi, fshirja dhe larja e rrugëve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
16	Pastrimi, larja e tepihave dhe karrigeve	Në proces të prokurimit
17	Pastrimi dhe larja e automjeteve	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
18	Servisimi, mirëmbajtja dhe mbushja e klimave	Në proces të prokurimit
19	Transporti i nxënësve	Në procedurë të prokurimit
20	Shërbimet e sigurimit shëndetësor të nxënësve gjatë praktikës profesionale	Në proces të prokurimit
21	Shërbimet e deratizimit, dezinfektimit dhe dezinfektimit	Në procedurë të prokurimit
22	Shërbime mediale për aktivitete të Komunës së Vushtrrisë	PO

23	Shërbimet për asgjësimin e mbeturinave medicinale	Në proces të prokurimit
24	Shtypja e materialeve të ndryshme zyrtare	Në proces të prokurimit
25	Punimi i dekoratave	Në proces të prokurimit
26	Mirëmbajtja e nyjeve sanitare, ujësjellësit dhe rrjetit elektrik në objekte	Në proces të prokurimit
27	Servisimi dhe mirëmbajtja e ashensorëve	Në proces të prokurimit
28	Shërbime të përkthimeve	Në proces të prokurimit
29	Shërbime konsulente profesionale për persona individual për Drejtorinë për Buxhet, Thesar dhe Financa	PO (është proceduar, por nuk ka pasur sukses)
30	Shërbime konsulente profesionale për persona individual për Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes të Mjedisit	PO (është proceduar, por nuk ka pasur sukses)
31	Shërbime konsulente profesionale nga persona individual për Zyrën e Kryetarit	PO (është proceduar, por nuk ka pasur sukses)
32	Shërbime konsulente profesionale nga persona individual për Drejtorinë e Inspektimeve	PO (është proceduar, por nuk ka pasur sukses)
33	Shërbime konsulente profesionale nga persona individual për Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë	PO (është proceduar, por nuk ka pasur sukses)
34	Servisimi, kontrolli dhe instalimi i programeve të pajisjeve gjeodezike	PO
35	Shërbime juridike për përfaqësim ligjor të komunës	PO
36	Shërbime me tenda dhe binë me zërim për aktivitete kulturore	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
37	Shtypja e materialeve për aktivitetet kulturore	Në procedurë të prokurimit
38	Rehabilitimi i zyrës në objektin e DGJKP	PO
39	Shtypja e posterave për promovimin e profileve të SHMP “Bahri Haxha”	PO
40	Shtypja dhe botimi i monografisë të gjimnazit	PO
41	Servisimi i gjeneratorëve në shkolla	PO
42	Martja me qira e tendës me 200 karrige dhe tualeteve mobile	PO
43	Hartimi i tri (3) projekteve për investime kapitale	Në procedurë të prokurimit

Duke u bazuar në planifikimin e prokurimeve për vitin fiskal 2022, sa i përket shërbimeve nga numri i përgjithshëm prej 43 prokurimeve, janë inicuar 20 apo shprehur në përqindje

46.51%, ndërsa të painicuarat janë 23 apo shprehur në përqindje 53.49% të prokurimeve të planifikuara.

II. 3) KONTRATAT PËR PUNË

	Përshkrimi i kontratës / Karakteristikat thelbësore të secilës kontratë për punë	Projekti është realizuar PO / JO
1	Ndërtimi i rrugëve me kubëza betoni rr. “Skënderbeu, Bekim Zenuni, Mursel Hyseni“	Nuk është inicuar nga njësi e kërkesës
2	Ndërtimi i kanalizimeve Samadrexhë, Maxhunaj, Smrekonicë	Në procedurë të prokurimit
3	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal rr. „Dëshmorët e kombit, I. Qemajli, Bekim Berisha“	Nuk është inicuar nga njësi e kërkesës
4	Ndërtimi i sheshit dhe parqeve në qytet, fsh. Stroc dhe Smrekonicë	Nuk është inicuar nga njësi e kërkesës
5	Regullimi i varrezave të qytetit – Vushtrri	Në procedurë të prokurimit
6	Ndërtimi i vigave mbi lumin “Silnica, Tërstena dhe Stanoc”	PO
7	Rikonstruktimi i rrugëve të asfaltuara	Në proces të prokurimit
8	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në Vushtrri, Dobërllukë, Maxhunaj, Stanoc	Nuk është inicuar nga njësi e kërkesës
9	Ndërtimi i urave dhe mureve mbrojtëse në Stanoc dhe Pantinë	PO
10	Ndërtimi i rrugëve lokale në fshatra	Nuk është inicuar nga njësi e kërkesës
11	Ndërtimi i parqeve	Nuk është inicuar nga njësi e kërkesës
12	Rregullimi i argjinaturave të lumit “Silnica”	Nuk është inicuar nga njësi e kërkesës
13	Ndërtimi i aneksit në QKMF Vushtrri (depo dhe garazhë)	PO
14	Renovimi dhe ngjyrosja e QMF-1 në Vushtrri	Në procedurë të prokurimit
15	Rindërtimi i laboratorit në QMF-3 në Vushtrri	Në procedurë të prokurimit
16	Rregullimi i oborrit të QKMF-së në Vushtrri	PO
17	Ndërtimi i recepcionit në QMF-3	Në procedurë të prokurimit
18	Rregullimi i nyjeve sanitare në objektin e administratës komunale	Në procedurë të prokurimit

19	Ndarja fizike e objektit të në administratën komunale	Në procedurë të prokurimit
20	Renovimi i Palestrës “Jeton Tërstena”	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
21	Ndërtimi i objektit ndihmës në stadium	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
22	Ndërtimi i depos në Qendrën rinore “Naxhije dhe Fahri Buçinca”	JO
23	Ndërtimi i fushës sportive dhe rrethojës në SHMU Lumadh	Në procedurë të prokurimit
24	Ndërtimi i tualeteve në SHMU “ Emin Duraku”	PO
25	Ndërtimi i platosë me kubëza betoni në SHMU në Vushtrri	Në procedurë të prokurimit
26	Ndërtimi i fushës sportive në SHMU “Enver Hadri”	Në procedurë të prokurimit
27	Ndërtimi i deposë në Shf. “Naim Frashëri” në Vushtrri	PO
28	Ndërtimi i deposë në Shf. “Latif Berisha” në fshatin Dobërlukë	PO
29	Ndërtimi i deposë në Shf. “Mustafë Shyti” në fshatin Oshlan	PO
30	Ndërtimi i rrethojës në SHMU “Mustafë Shyti” në fshatin Oshlan	Në procedurë të prokurimit
31	Ndërtimi i rrethojës në SHFU “Rilindja” në fshatin Vilanc	Në procedurë të prokurimit
32	Renovimi i objektit të SHMU “Adem Voca” në fshatin Pasomë	PO
33	Renovimi i objektit të SHMU “Lumni Surdulli” në fshatin Samadrexhë	PO
34	Renovimi i objektit të SHMU “Enver Hadri” në fshatin Smrekonicë	PO
35	Renovimi i objektit të SHMU “Rilindja” në fshatin Vilanc	PO
36	Renovimi i objektit të Shf. “Ali Kelmendi” në fshatin Studime	PO
37	Renovimi i objektit të SHFMU “Mihaliqi” në fshatin Mihaliq	PO
38	Renovimi i objektit të SHFMU “Rexhep Musa” në fshatin Ceceli	PO
39	Rregullimi i SHFMU në fshatin Stanoc me infrastrukturë	Në procedurë të prokurimit
40	Renovimi i objektit dhe ndërtimi i tualeteve në Shf. “Naim Frashëri” në Vushtrri	PO

41	Renovimi i objektit të SHFMU "Azem Bejta" në fshatin Beçiq	PO
42	Renovimi i ngrohjes qendrore në SHMP "Bahri Haxha"	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
43	Ndriçimi i oborrit të shkollës	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
44	Renovimi i qendrës rezidenciale	Në procedurë të prokurimit
45	Renovimi i objektit të njësisë së zjarrfikësve	Në procedurë të prokurimit
46	Ndërtimi i sallës në objektin e komunës	Në proces të prokurimit
47	Ndërtimi i depos	Në procedurë të prokurimit
48	Ndërtimi i shkollës në fshatin Gllavin	Nuk është inicuar nga njësia e kërkesës
49	Asfaltimi i rrugës Vesekoc-Sllakoc	Në procedurë të prokurimit
50	Ndërtim i depos për mbeturina medicinale	Në procedurë të prokurimit
51	Ndërtimi i zyrave të administratës të QKMF-së	Në procedurë të prokurimit
52	Ndërtimi i shëtitores dhe shtegut për biçikleta Vushtrri-Nedakoc, bri lumit "Silnica"	Në procedurë të prokurimit

Duke u bazuar në planifikimin e prokurimeve për vitin fiskal 2022, sa i përket projekteve kapitale/punëve, nga numri i përgjithshëm prej 52 prokurimeve, janë inicuar 37, apo shprehur në përqindje 71.15%, ndërsa të painçuara janë 15, apo shprehur në përqindje 28.85% të projekteve të planifikuara.

ADMINISTRATË

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar dhe iu është dhënë përgjigje të gjitha kërkesave të palëve për të cilat parashihet afati me i shkurtër 1-7 ditë, ndërsa për kërkesat për të cilat parashihet afat më i gjatë deri 45 ditë për përgjigje në kërkesë pas shqyrtimit në komisionin përkatës dhe pas aprovimit dhe shqyrtimit nga Agjencioni i Regjistrimit Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë përfunduar brenda afateve që parashihen në ligjet pozitive të Republikës së Kosovës.

Zyra e gjendjes civile i ka marrë të gjitha masat që të zbatojë vendimin e MAPL-së për shpalljen e muajit prill si muaj për regjistrimin falas të të gjitha fakteve të lindjes për komunitetin RAE, mirëpo në Zyrën e gjendjes civile në Komunën e Vushtrrisë nuk është paraqitur asnjë rast i këtij komuniteti për regjistrim me vonesë dhe falas.

Shërbimi i gjendjes civile është duke punuar sipas orarit të caktuar nga Kryetari i komunës, prej orës 08:15 deri në ora 15:45 pa ndërprerë, kështu që edhe në kohën e pauzës punojmë

me kujdestari duke ju shërbejmë të gjithë qytetarëve. Po ashtu e kemi funksionalizuar edhe E- Kioskun ku qytetarët marrin shërbim 24 orë në ditë dhe 7 ditë në javë.

Zyra e gjendjes civile ka bërë përgatitjet edhe për pritjen e bashkatdhetarëve gjatë muajve të verës ku kërkesat për certifikata dhe për shërbime tjera nga gjendja civile janë më të mëdha, andaj me vendim të Kryetarit të komunës kemi filluar që të punojmë edhe të shtunave prej orës 10:00 deri në ora 14:00 dhe kemi caktuar 3 sportele të veçanta vetëm për bashkatdhetarët me qëllim që të krijojmë kushte për trajtim sa më të mirë dhe për një shërbim sa më të shpejtë për mërgimtarët e komunës sonë. Në vazhdimësi jemi duke bashkëpunuar ngusht me gjykatat e Kosovës, Entin e sigurimeve pensionale të Kosovës dhe të shteteve të huaja dhe çdo kërkesë i përgjigjemi në kohë brenda ditës ose sipas afateve që i cakton gjykata, ngase kërkesat e gjykatës janë gjithmonë me urgjencë dhe si të tilla edhe i trajtojmë.

Certifikatat dhe dokumentet e lëshuara gjatë periudhës janar-qershor 2022

Nr.	Lloji i certifikatës	Totali
1.	Certifikata të lindjes	6511
2.	Ekstrakte nga regjistri qendror	16486
2.	Certifikata të martësës	4094
3.	Certifikata të statusit martesor	717
4.	Certifikata të vendbanimit	1038
5.	Certifikata të shtetësisë	177
6.	Deklarata të bashkësisë familjare	4130
7.	Certifikata të vdekjes	1470
8.	Vërtetime nga arkivi	388
Gjithsej		35011

Regjistrimet në regjistrat e gjendjes civile:

1	Regjistrime të lindjes	147
2	Martesa	381
3	Regjistrime të vdekjes	192
4	Regjistrime të shtetësisë	8
5	Regjistrime të lindjes jashtë shtetit	78
6	Regjistrime të martesës jashtë shtetit	23
7	Regjistrime të vdekjes jashtë shtetit	26
Gjithsej regjistrime të bëra		855

Gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e qytetarëve dhe janë nxjerrë këto vendime dhe shkresa tjera:

1.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të lindjes	8
2.	Vendime për regjistrime me vonesë të faktit të vdekjes	22
2.	Vendime për ndërrimin e emrit personal	23
3.	Vendime për korigjime të të dhënave personale në RQ	12
4.	Vendime për korigjimin e të dhënave në regjistra fizik	27
5.	Vendime për anulimin e faktit të lindjes	12
6.	Dëshmi të vdekjes	118
7.	Lajmërim dhe çlajmërim të adresës së vendbanimit	278
8.	Vendime për korigjimin e akteve të lindjes,	4
9.	Vendime për korigjimin e akteve të vdekjes	3
9.	Vendime për korigjimin e akteve të martesës	0
10.	Aplikime për natyralizim (fitim të shtetësisë)	11
11.	Aplikime për humbje të shtetësisë së Kosovës me lirim	35
12.	Aplikime për rikthimin e shtetësisë së Kosovës	6
13.	Aplikime për fitimin e shtetësisë me martesë	5
Gjithsej regjistrime të bëra		564

Në këtë periudhë janë verifikuar 800 qytetarë në sistemin e ri të gjendjes civile, ndërsa që nga fillimi i sistemit të ri më 19.2.2013 janë të verifikuar apo të regjistruar në sistemin e gjendjes civile 101470 qytetarë të Komunës së Vushtrrisë.

Në kuadër të organeve të administratës janë paraqitur gjithsej 34 247 kërkesa, prej të cilave janë:

Nr.	Përshkrimi	Nr. i Kërkesave
1	Drejtoria për Administratë	19913
2	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	4591
3	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	5859
4	Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim Rural	134
5	Drejtoria për Shërbime Publike	518
6	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	1048
7	Drejtoria për Arsim	370
8	Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit	397
9	Drejtoria për Inspektime	288
10	Personeli	629
11	Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim	83

12	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	176
13	Zyra ligjore	30
14	Kryetari i komunës	170
15	Drejtoria e Prokurimit	5
16	Kuvendi i komunës	25
17	Zyra lokale e komuniteteve	7
18	Njësia e auditimit të brendshëm	3
20	Zyra për integritet evropian	1
		34247

ARSIMI

Drejtoria e Arsimit, gjatë periudhës janar-qershor 2022, ka arritur me sukses dhe rezultate të kënaqshme t'i realizojë punët dhe detyrat e parapara sipas planit të veprimit me punë dhe aktivitete të ndryshme bazuar edhe në kërkesat në terren.

Gjendja me COVID 19 në shkollat e komunës

Procesi edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, mbështetet dhe mbikëqyret në vazhdimësi nga zyrtarët e arsimit, kryhen vizita pune, monitorime të gjendjes në shkolla, duke përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve dhe aktiviteteve të ndryshme që organizohen në shkollat e Komunës së Vushtrrisë. Po ashtu gjatë muajit shkurt dhe mars kemi pas edhe situatë pandemie. Me kohë është bërë dezinfektimi i shkollave, po ashtu edhe janë shpërndarë mjete higjienike, maska dhe dezinfektues në të gjitha shkollat.

Nga 21 shkurti gjendja është normalizuar por mbeten në fuqi që shkollat t'i respektojnë masat dhe këshillat profesionale që vijnë nga IKSHPK.

Vizita pune dhe monitoruese - këshilluese në institucionet arsimore

Bazuar në planin dinamik të punës dhe kërkesave nga drejtorët e shkollave, DKA me zyrtarët e saj, gjatë periudhës janar-qershor kanë vizituar shkollat e Komunës së Vushtrrisë që kanë ndihmuar në tejkalimin e vështirësive në disa shkolla me dhënien e rekomandimeve.

Vizitat në disa shkolla janë kryer edhe në bashkëpunim me inspektorët regional të arsimit, me qëllim të ngritjes së cilësisë në mësimnxënie dhe mësimdhënie.

Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje të shkollave dhe palëve të interesit

- Takime të rregullta me drejtorë të shkollave;
- Takime të rregullta me komunitetin dhe organet e sigurisë;
- Trajnimi me përfaqësues të OJQ “Shpresë” të Caritasit zviceran për krijimin e databazave në institucionet edukativo-arsimore për klasat përgatitore, mbajtjen e trajnimeve me zyrtarë të DKA-së dhe edukatore, për zhvillimin e fëmijëve në edukimin e hershëm dhe aplikimin e metodave për zhvillimin e aktiviteteve përmes lojës;
- Trajnim i koordinatorëve të cilësisë në shkolla për përkrahje të edukatoreve të klasave përgatitore përmes projektit “Shpresë”;
- Takime në MASHT me drejtorët komunal të arsimit;
- Takime me policinë në komunitet, bazuar në planin e veprimit për menaxhimin e rasteve që paraqiten në shkollat e Komunës së Vushtrrisë për të planifikuar aktivitete të përbashkëta me qëllim të krijimit të ambienteve të sigurta, vetëdijesimin e nxënësve në përmirësimin e situatës së sigurisë në shkolla;
- Takime me inspektoratin e punës;
- Takime me inspektorët regjional të arsimit;
- Takime me KFOR-in slloven;
- Takime të rregullta të Asociacionit të Komunave të Kosovës, Kolegjiumit për Arsim;
- Takim me drejtorin e SHMP “Bahri Haxha” për shkollat e Ballkanit, lidhur me projektin <Super Schools> i organizatës RYCO;
- Takime me përfaqësues të KEC me DKA-Vushtrri në realizimin e aktiviteteve të planifikuara në projektin “Së bashku kundër abuzimit të nxënësve”;
- Takim përmbledhës për vitin 2021 me KEC & FIT me ekipin komunal “Së bashku kundër abuzimit të fëmijës”;
- Takime me përfaqësues të OJQ Qendra për demokratizimin e shoqërisë civile „Koralet” për mbështetjen institucionale dhe rritjen e gjithëpërfshirjes në nivelin e parë të sistemit të arsimit, edukimin parashkollor;
- DKA- synon rritjen e gjithëpërfshirjes së fëmijëve në edukim parashkollor dhe bazuar në marrëveshjen e bashkëpunimit janë të angazhuar pesë edukatore që punojnë në shkollat tona me fëmijë të klasave përgatitore;
- Takime me përfaqësues të OJQ “Terre Des Mommès Kosovo” për angazhim të pesë mësimitdhënëseve që punojnë në dy shkolla me mësime plotësues me fëmijë të riintegruar apo që kanë vështirësi në të nxënë;
- Takime me përfaqësues të komunitetit RAE për mbështetje të këtij komuniteti përmes OJQ “VREA” me material didaktik dhe pagesa e qirasë në objektin – shkollë për këtë komunitet në Prelluzhë;
- Takime me mësues udhëtues të QB “Xheladin Deda” Pejë.
- Takim me përfaqësuesit e organizatës “BOZporus” nga Holanda lidhur me renovimin e paraleles në Beçiq;
- Takim me përfaqësuesit e organizatës “Up to youth” – USAID lidhur me infrastrukturën shkollore;

- Takim me përfaqësuesin e ICMLD rreth projektit MIS 2, edukimi mjedisor në arsimin parashkollor;
- Takime me drejtorin e GIZ-it z.Tobias Seiberlich dhe përfaqësuesit e projektit “Fit for Job”;
- Me ftesë të Ambasadores të Republikës së Francës në Kosovë, Shkëlqësisë së saj znj. Marie-Christine Butel, një delegacion nga komuna jonë ishim në vizitë zyrtare disaditore në Francë, misioni diplomatik i Kosovës në Hauts-de-France;
- Takim pune me ekipin e Qendrës Psiko-Sociale për Traumaterapi-Diakonie Kosova;
- Takim pune me drejtorë komunal të arsimit, Teach For Kosova lansoi projektin "Future of Education", që ka për qëllim krijimin e një instrumenti për vlerësimin e mësimdhënësve, i cili është i aplikueshëm për mësimdhënësit në mbarë Kosovën. Rezultati kryesor i projektit është një mekanizëm i vlerësimit të mësimdhënësve, i cili është gjithëpërfshirës, i drejtë dhe përmbledhës.

Bazuar në Rregulloren për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblimeve për Nxënës të Komunës së Vushtrrisë, DKA për vitin akademik 2021/22 ka shpallur konkursin për ndarjen e 70 (shtatëdhjetë) bursave komunale për studentë të rregullt të nivelit baçelor. Kriteret për përfitimin e bursës i kanë plotësuar 48 (katërdhjetë e tetë) studentë, të cilëve ju është ndarë bursa në vlerë prej 400.00 €;

Tani është publikuar edhe konkursi plotësues për ndarjen e 22 (njëzet e dy) bursave për studentë të rregullt të nivelit baçelor për vitin akademik 2021/22, në vlerën prej 400.00 €.

GARAT KOMUNALE DHE REPUBLIKANE TË FIZIKANTËVE TË RINJ TË KOSOVËS

Më 12 shkurt 2022, në Gjimnazin „Eqrem Çabej“-Vushtrri, janë mbajtur garat e Fizikanëve të rinj në nivel komune, për nx. e kl. 9, 10, 11 dhe 12. Drejtoria Komunale e Arsimit i ka shpërblyer nxënësit që kanë arritur rezultate më të mira, me mirënjohje dhe mjete materiale. Vendi i parë me 150.00 €, vendi i dytë 120.00 € dhe vendi i tretë me 100 €.

Më 27 shkurt 2022, kemi marrë pjesë në Garat republikane të fizikanëve të rinj që u mbajtën në Fakultetin e Shkencave Natyrore në Prishtinë. Në këtë garë kemi marrë pjesë me nga një nxënës nga kl. 9, 10, 11 dhe 12, që janë përzgjedhur nga gara komunale e mbajtur më 12.2.2022.

Drejtoria Komunale e Arsimit për këtë garë, i ka shpërblyer të dy nxënëset me mirënjohje dhe mjete materiale në shumën 250.00 €. Për këtë garë janë shpërblyer 9 nxënës në shumën prej 1,360.00 €.

GARAT KOMUNALE DHE REPUBLIKANE NË OLIMPIADËN MATEMATIKE TË KOSOVËS

Më 19 shkurt 2022, në SHMU-2, në Vushtrri, janë mbajtur garat e OMK në nivel komune, për nx. e kl. 9,10,11 dhe 12. Drejtoria Komunale e Arsimit i ka shpërblyer nxënësit që kanë arritur rezultate më të mira, me mirënjohje dhe mjete materiale. Vendi i parë me 150.00 €, vendi i dytë 120.00 € dhe vendi i tretë me 100 €.

Më 6 mars 2022, kemi marrur pjesë në garat republikane të OMK që u mbajtën në Gjimnazin e Specializuar të Matematikës në Prishtinë. Në këtë garë kemi marrur pjesë me 5 (pesë) nxënës nga kl.9, 10, 11 dhe 12 që janë përzgjedhur nga gara komunale, mbajtur më 19.2.2022.

Për këtë garë janë shpërblyer 12 nxënës në shumën prej 1,480.00 €.

Gjithsej për garat në fizikë dhe matematikë janë shpërblyer 21 nxënës në shumën 2,840.00 €.

Garat e diturisë dhe gara tjera të mbajtura gjatë periudhës janar – qershor 2022

1. Nxënësit të cilët kanë arritur rezultate më të mira në **Garat komunale të diturisë** që u mbajtën më 4.5.2022, në lokalet e gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri për klasat e (IX) nënta, me dt. 25.5.2022 në SHMT ”Lutfi Musiqi në Vushtrri me klasa të pesta, vendi i parë, i dytë dhe i tretë u shpërblyen me mirënjohje dhe në të holla. Vendi i parë është shpërblyer me 100 (njëqind) euro, vendi i dytë 75 (shtatëdhjetë e pesë) euro dhe vendi i tretë me 50 (pesëdhjetë) euro.
2. Nxënësit të cilët kanë arritur rezultate më të mira në **Garat komunale të diturisë** që u mbajtën më 10.5.2022, në lokalet e gjimnazit “Eqrem Çabej” në Vushtrri për klasat e (XII) dymbëdhjeta, vendi i parë, i dytë dhe i tretë të shpërblehen me mirënjohje dhe në të holla. Vendi i parë të shpërblehet me 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro, vendi i dytë 100 (njëqind) dhe vendi i tretë me 100 (njëqind) euro.
3. Nxënësit që kanë arritur rezultate më të mira në nivel vendi në **Garat “Kodimi” Shkolla e shekullit 21**, që u mbajtën më dt. 20.5.2022 për klasat 6-9, në nivel republikan, vendi i parë, është shpërblyer me mirënjohje dhe në të holla. Vendi i parë me 150 (njëqind e pesëdhjetë) euro.
4. Nxënësit të cilët kanë arritur rezultate më të mira në **Garat ”Ditës së sigurt të internetit”** që u mbajtën më 8.2.2022, për klasat 6-9, vendi i parë është shpërblyer me mirënjohje dhe në të holla. Vendi i parë me 100 (njëqind) euro, vendi i dytë me 75 (shtatëdhjetë e pesë) euro dhe vendi i tretë me 50 (pesëdhjetë) euro.
5. Nxënësit të cilët kanë arritur rezultate më të mira në **Garat ”Gjeniu i Kosovës”** që u mbajtën më 24.5.2022, në nivel republikan për klasat 6-9, vendi i parë, është shpërblyer me mirënjohje dhe në të holla. Vendi i parë me 100 (njëqind) euro.

Për këto gara janë shpërblyer 38 nxënës që u renditën në vendet e para, të dyta dhe të treta në shumën 3225 €. Po ashtu DKA ka ndarë edhe mirënjohje për nxënësit fitues të garave.

Për organizim dhe mbarëvajtje të garave të diturisë me klasa të pesta, të nënta dhe të dymbëdhjeta, janë shpërblyer edhe anëtarët e ekipeve punuese.

Në Garat republikane në ping pong, nga komuna jonë morën pjesë: SHMP “Bahri Haxha” meshkujt, SHMU -2 meshkujt, SHMP “Bahri Haxha” u rendit në vendin e parë në nivel republikan, kurse SHMU -2 e zuri vendin e tretë.

Më datë: 31.3.2022 u mbajtën Garat republikane në hendboll të organizuara nga Federata e Sportit Shkollor e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën e pedagogëve të

Komunës së Vushtrrisë si vend nikoqir. Nga komuna jonë morën pjesë: SHMU “Lumni Surdulli” femrat, SHMU -2 meshkujt dhe Gjumnazi “Eqrem Çabej” femrat.

Në nivel republikan, Komuna e Vushtrrisë fitoi këto vende: vendi i parë SHFMU “Lumni Surdulli” Samadrexhë (femrat).

U mbajtën Garat regjionale (Regjioni i Mitrovicës) në futsall, shkollat e mesme të ulëta edhe ato të larta. Komuna e Vushtrrisë u përfaqësua nga shkollat fituese të garave në nivel komunal dhe u Vendi i parë: SHMU “Liria” Stroc - femrat;

Vendi i parë: SHMU -2 Vushtri – meshkujt;

Vendi i parë: Gjumnazi “Eqrem Çabej” – meshkujt;

Vendi i dytë: Gjumnazi “Eqrem Çabej” – femrat.

Më datë 29.4.2022 u mbajtën Garat republikane në futsall, të organizuara nga Federata e Sportit Shkollor e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Shoqatën e pedagogëve të Komunës së Drenasit si vend nikoqir;

Nga komuna jonë morën pjesë: SHMU “Liria” femra, SHMU - 2 meshkujt, Gjumnazi “Eqrem Çabej” meshkujt, me renditje:

Vendi i parë SHMU - 2 meshkujt, vendi i dytë Gjumnazi “Eqrem Çabej” meshkujt, kurse SHMU “Liria” Stroc ka zënë vendin e tretë.

SHMU – 2, më 30 prill mori pjesë në kuizin “Big Bang” dhe dolën të parët në raundin e parë.

PARANDALIMI DHE REAGIMI NDAJ BRAKTISJES SË MËSIMIT

Ekipi për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes së mësimin në nivel komunal është funksional dhe bashkëpunon me akterë të ndryshëm, me qëllim të kthimit të nxënësve të braktisur në shkolla.

PROJEKTI: VLERËSIMI VULLNETAR LOKAL

Komuna e Vushtrrisë, së bashku me zyrën e UN-Habitat-it në Kosovë dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, po e hartojnë raportin e parë në Kosovë të «Vlerësimit vullnetar lokal, për të monitoruar dhe raportuar arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe kontributin e tyre për agjendën 2030». Përgatitja e këtij raporti ka kërkuar disa hapa dhe mbledhjen e të dhënave nga niveli qendror, lokal, komunitetet dhe sektorët e tjerë. UN-Habitat ka përgatitur një pyetësor, i cili ka pas qëllim mbledhjen e disa të dhënave që nuk gjenden as në Agjencinë e Statistikave të Kosovës dhe as në departamentet ndërkomunale. Andaj me kërkesën e UN-Habitat-it, DKA në bashkëpunim me drejtorin e shkollës së SHMP „Bahri Haxha”- janë pajtuar që në sajë të bashkëpunimit dhe me pajtimin e prindërve, t’i angazhojnë nxënësit në kuadër të praktikës, pra në ditët që nxënësit kanë praktikë profesionale. Kështu, gjatë periudhës 26 prill e deri më 6 maj 2022, gjithsej 7 ditë, 30 nxënës (20 nga drejtimi arkitekturë dhe 10 të drejtimit shpedicion dhe logjistikë) nga SHMP ”Bahri Haxha”, në bashkëpunim me UN-Habitat janë angazhuar në mbledhjen e të dhënave në projektin e hartimit të raportit për **Vlerësimin Vullnetar Lokal për Komunën e Vushtrrisë**. Nxënësit kanë qenë të angazhuar sipas drejtimeve, nga 10 nxënës në ditë, ku transporti është siguruar nga DKA, ndërsa ushqimi nga UN-Habitat.

TRANSPORTI I NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Janë përkrahur financiarisht 48 (katërdhjetë e tetë) prindër në mbulimin e shpenzimeve të transportit për fëmijët e tyre me nevoja të veçanta, të cilët i vijnë në mesimet në Qendrën burimore „Xheladin Deda” në Pejë, Qendrën burimore „Nënë Tereza” në Prizren, Qendrën burimore „Nënë Tereza” në Mitrovicë, Shoqatën DOWN (DAUNË) Syndrome Kosova-DSK –Mitrovicë, në shkollat e komunës sonë dhe të cilët kanë vizita të rregullta mjekësore. Shuma e mjeteve të përkrahjes në gjashtëmujorin e parë është 18,300.00 euro.

TRANSPORTI I NXËNËSVE

Transporti i nxënësve për 35 (tridhjetë e pesë) linja është në procedurë të tenderimit

DONACIONE - Më 15.3.2022, JICA- Japoneze, në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Kosovës në nivel qendror dhe lokal, në kuadër të projektit „Strategjia e Qëndrueshmërisë ndaj Fatkeqësive”, i ka dhuruar SHFMU „Jusuf Gërvalla” – Dumnicë e Poshtme/K.Vushtrri, pajisje të ndryshme kundër zjarrit dhe fatkeqësive tjera si: aparate kundër zjarrit, shtrat për bartjen e të lënduarve, lopata, çizme, doreza, helmeta, aparate për alarm, shkallë, gjenerator, motor për largimin e ujit, komplet të ndihmës së parë etj. Për vlerën e këtyre pajisjeve nuk kemi faturë, por sipas deklarimit të donatorit shuma është 10,000.00 €.

DONACIONET

Donacionet në SHMU/IMë datë 30.6.2022 është pranuar një donacion nga GIZ me vlerë 2.086.57 euro. *Donacionet në SHML- Gjinnazi "Eqrem Çabej" Vushtrri*, Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), gjithsej shuma e përgjithshme është 17.835 euro, ndërsa ASSET - USAID ka dhënë inventar dhe pajisje teknologjike të përdorura në vlerë prej 2539 \$ (dollarëve).

Donacioni në SHFMU "Jusuf Gërvalla" Dumnicë e Poshtme. Kjo shkollë ka fituar një donacion në vlerë afër 200 mijë euro nga salloni "Alberti".

Operimi i ekipit vlerësues pedagogjik për FNV arsimore

Ekipi vlerësues pedagogjik për fëmijë me nevoja të veçanta gjatë periudhës janar-qershor 2022 ka realizuar 34 vlerësime pedagogjike të FNV në shkolla të ndryshme të komunës sonë, bazuar në kërkesat e paraqitura për vlerësim. Janë realizuar edhe vizita në QB në Pejë.

Zbatimi i KKK-së në shkollat e komunës sonë

DKA në bashkëpunim dhe koordinim me MASHT ka vazhduar politikën zhvillimore në mbështetje të vazhdueshme për zhvillimin profesional të mësimit në shkollat. Gjatë muajit shkurt janë vlerësuar dosjet e 66 mësimit në shkollat të fushave të ndryshme të KK nga trajnerët e KKK-së. Trajnimi do të vazhdojë edhe për mësimit në shkollat që janë pranuar së fundmi

Testet e mbajtura me nxënës:

- Testi TIMSS me nxënësit e klasave të katërta të SHFMU "Liria" Stroc dhe SHFMU "A.Z Çajupi;
- Testi Ndërkombëtar ICILS me nxënës të klasave të teta, u zgjodh nga MASHT-i, SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri për testin ICILS - Faza Pilot;
- Testi PISA 2022;
- Testi i arritshmërisë.

Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme të zhvilluara përmes projektit TACA "Së bashku kundër abuzimit të fëmijës" dhe projekteve tjera.

Suksesi i nxënësve në fund të gjysmëvjetorit të dytë të vitit shkollor 2021/2022

GJ. II viti shkollor 2021/22																					
Klasë	Shkëlqyeshëm	%	Sh. mirë	%	Mirë	%	Mjaftueshëm	%	Të pa notuar	%	Me një notë të dobët	%	Me dy nota të dobëta	%	Kanë përsëritur klasën	%	Me tri e më shumë nota të dobëta	%	Përcillen me nota negative	%	Gjithsej
1--5	3309	65.64	1051	20.66	527	10.34	162	3.20	2	0.04	6	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	5057
6--9	1179	29.12	872	21.52	1073	26.53	700	17.36	4	0.10	112	2.75	87	2.12	21	0.00	0	0.00	0	0.00	4048
10--12	341	13.89	492	19.91	744	30.11	502	20.44	11	0.43	145	5.73	180	7.08	4	0.15	50	2.01	6	0.25	2475

Rezultatet e testit të arritshmërisë, arritshmëria në nivel komunal 44.74%;

Vërejtje: Për të dhëna tjera rreth suksesit të nxënësve do t'ju referohemi në shtator kur do t'i kemi të dhënat e plotësuara në SMIA.

SFIDAT

- Mungesa e kandidatëve për lëndën gjuhë gjermane;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Mungesa e hapësirave për klasat përgatitore në SHF "Mustafë Venhari" Vushtrri;
- Mungesa e dhomave për moshën 0-1 vjeç në IP "Foleja 2" Vushtrri;
- Numri i shtuar i FNV në shkollat e Komunës së Vushtrrisë dhe mungesa e asistentëve (për momentin janë të punësuara vetëm 3 asistente);
- Mungesa e punëtorëve teknik në disa shkolla të komunës sonë;
- Përkrahje për nxënësit me aftësi të jashtëzakonshme, dhunti dhe talentë;
- Mbështetje për nxënësit me nevoja të veçanta.

SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Shërbimet shëndetësore në QKMF, janar-qershor 2022

Nr	Emri i shërbimit	Totali	Me-shkuj	Fe-mra	Pacientë që kanë partici-puar	Shë-rbim	Refer-ime	Mali-nje	Kron-ike	Të vizi-tuar me kart-elë
1	QKMF	32439	15406	17033	4828	10639 1	4768	17	1939	224
2	Urgjenca	15639	7093	8546	1357	83287	1818	42	3405	0
3	Laboratori	7491	2990	4498	1509	69504	0	0	0	0
4	Stomatolo - gjia	4620	2136	2484	522	25874	148	0	0	806
5	RTG	3144	1420	1704	616	8271	0	0	0	0
6	Rtg e dhëmbit	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	Vaksinimi	2271	1227	1044	0	9237	0	0	0	1879
8	QMF-1	22601	10479	12122	3772	64919	3186	9	1180	302
9	QMF-2	2885	1290	1595	323	28316	177	3	168	140
10	QMF-3	3564	1600	1964	450	22761	10	0	278	0
11	QMF-AMF	10316	4420	5896	1095	36441	2378	16	1124	1744
12	V. shtëpiake	2566	1228	1338	0	12830	1	0	0	489
13	Këshillimore AQH	724	328	396	0	3128	0	0	891	220
	Gjithsej	108,260	49,61 7	58,62 0	14,472	47095 9	12,486	87	8,985	5,804

QMF dhe AMF

	Janar- qershor 2022	Totali	M	F	Partici -pim	Shërbi- me tjera	Referi- met	S. malinje	S. kronike	Vizita me kartelë
QMF dhe AMF	QMF Lumadh	3191	1394	1797	458	9263	179	2	284	310
	QMF Smrekonicë	1203	548	655	201	7229	685	1	101	118
	QMF Pantinë	1282	525	757	231	5409	361	19	179	482
	QMF Druar	667	288	379	62	1743	281	0	20	12
	QMF Novolan	287	111	176	11	2466	81	2	48	197
	QMF Maxhunaj	1512	615	897	207	5304	399	0	187	0
	QMF Dumnicë	275	97	178	11	1768	75	0	41	229
	AMF Samadrexhë	438	170	268	24	4147	101	0	418	101
	AMF Stroc	334	124	210	4	1210	51	0	75	0
	AMF Pasomë	352	159	193	1	1717	4	0	5	127
	AMF Oshlan	112	54	58	5	1539	36	0	15	90
	AMF Beçiq	168	96	72	6	643	44	0	8	0
	Amf Duboc	118	86	32	0	410	6	0	4	0
	AMF Ceceli	137	57	80	29	1553	13	0	14	0
	Gjithsej	10076	4324	5752	1250	44401	2316	24	1399	1666

Sektori i shëndetit publik

Është përgjegjës për imunizim dhe vaksinim, si dhe për sistemin informativ shëndetësor. Ky sektor përcjell gjendjen epidemiologjike në bazë të raporteve kthyesë nga IRSHP dhe bashkë me ta vepron në rast se kërkohet apo dyshohet në ndonjë epidemi. Në vitin 2022

kemi kryer vizita sistematike për nxënës nëpër shkolla (andaj do të përgatitet raport i punës).

Vaksinimi në Vushtrri është ndër më të mirët në Kosovë dhe arrin përqindje prej 95.0 %, në realizim të planit, e që është një bazë e mirë për preventivën e sëmundjeve që më herët kanë qenë të pranishme në Kosovë e rajon.

QKMF në Vushtrri në koordinim me shtabin emergjent komunal kanë caktuar vendet ku do të vaksinohen qytetarët me vaksinën kundër virusit Covid-19. Bazuar në raportin e IRSHP në Mintrovicë, kemi të raportuara 3270 raste të infektuara me visursin Covid -19, kurse prej tyre zyrtarisht janë të konfirmuara 89 raste të vdekjes. Që nga muaji mars 2021 deri më 31.12.2021 janë vaksinuar me dozë të parë 35591 pacientë, me dozë të dytë 32152 pacientë dhe me dozë të tretë janë vaksinuar 1135 pacientë, kurse në total janë dhënë 68878 doza të vaksinave. Po ashtu si çdo vit, për shkak të mbrojtjes së popullatës me rrezikshmëri më të lartë shëndetësore janë dhënë 2384 doza të vaksinave të gripit sezonal.

COVID-19

Është duke vazhduar pandemia edhe më tutje edhe pse situata epidemiologjike gjatë pesë muajve të parë të këtij viti ka qenë tejet stabile, kurse në muajin e fundit ka filluar rritja e numrit të rasteve me COVID-19. Gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti janë regjistruar **2203** raste me **4 viktima**. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, janë regjistruar më shumë raste të reja të virusit COVID-19, kurse gjatë vitit 2021 të të njëjës periudhë janë regjistruar **1610** raste dhe **47 viktima**.

Ministria e Shëndetësisë, së bashku me menaxhmentin e QKMF në Vushtrri kanë përcaktuar nevojat për staf profesional mjekësor, me qëllim të realizimit të planit të vaksinimit për aplikimin e vaksinave të lartpërmendura, me të cilën në koordinim me menaxhmentin kemi përfituar nga M.SH staf profesional mjekësor, mjekë dhe infermierë deri në muajin qershor, dhe kështu së bashku me stafin profesional dhe menaxherial të QKMF-së kanë punuar pa ndërprerë, me qëllim të arritjes së vaksinimit të të gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë. QKMF Vushtrri është furnizuar edhe me teste rapide nga Ministria e Shëndetësisë dhe bëhet testimi i pacientëve për virusin Covid-19. Gjatë periudhës janar – qershor 2022 janë bërë:

Përshkrimi	Negativ	Pozitiv	Gjithsej
Teste rapide	5099	1260	6359

Numri i total i vaksinave me dozën e I, dozën e dytë, dozën e III në Komunën e Vushtrrisë është 74339 vakcina.

Testimet me rapid test në QKMF Vushtrri janar-qershor 2022

Muaji	Negativ	Pozitiv	Gjithsej
Janar	2821	1055	3876
Shkurt	1827	169	1996
Mars	245	13	258
Prill	101	5	106
Maj	64	3	67
Qershor	44	17	61
Totali	6234	1495	7729

Kjo statistikë vlen vetëm për testimet në QKMF, kurse pjesa tjetër kanë kryer testime në IKSHP-Mitrovicë.

Spektori i vaksinimit dhe imunizimit:

Shërbimi i vaksinimit gjatë kësaj periudhe ka qenë i furnizuar me vakcina mjaftueshëm dhe është kryer në bazë të planit në qytet, si dhe në fshatra.

Në gjashtëmujorin e parë janë vaksinuar 2311 fëmijë me vakcina të rregullta, dhe janë dhënë 9768 shërbime.

Në fshatra, nxënës të klasëve të para, kanë qenë të planifikuar 518 nxënës.

Janë vaksinuar - 511 nxënës,

të pavaksinuar- 8 nxënës.

Në fshatra, nxënës të klasëve të- VI- kanë qenë të planifikuar 462 nxënës.

Janë vaksinuar – 450 nxënës,

të pavaksinuar - 12 nxënës.

Në qytet, nga klasat e para janë të planifikuar 511 nxënës.

Janë vaksinuar 500 nxënës,

të pavaksinuar 11 nxënës.

Në qytet, nga klasat e VI-janë planifikuar 502 nxënës.

Janë vaksinuar 490 nxënës,

të pavaksinuar 12 nxënës.

Nga nxënësit e kl. të para, në qytet e fshatra janë të vaksinuar 939 nxënës.

Nga nxënësit e kl. VI, në qytet e fshatra janë të vaksinuar 971 nxënës.

Maturantët - të planifikuar janë 843 nxënës.

Të vaksinuar 540 maturantë.

100 kanë refuzuar vaksinimin.

Me vakcina të gripit sezonal janë vaksinuar 1920 pacientë.

Barnatorja qendrore

Furnizimi me material shpenzues medicinal, barëra, insulina nga lista esenciale e MSH për periudhën kohore janar – qershor 2022, është realizuar në vlerë 183,591.50 euro.

Për shkak të mungesave gjatë furnizimit me barna dhe material shpenzues nga Ministria e Shëndetësisë, QKMF ka qenë e detyruar të bëjë blerjet e tyre nga buxheti i komunës përmes kornizë-kontratës me furnizuesin “Agani Ltd SHPK”.

Në tabelën e mëposhtme gjeni të bashkëngjitur përqindjen e furnizimeve nga MSH me barëra dhe material shpenzues për periudhën kohore janar – qershor 2022, nga lista esenciale:

Nr.	Përshkrimi i atirukjve	Mesatarja e produkteve medicinale në përqindje
1.	Insulina dhe medikamente	Mbi 90%
2.	Medikamente	54.13%

Shërbimi vizitat shtëpiake për nënën edhe foshnjën

Në koordinim dhe bashkëpunim të M.SH, UNICEF-in dhe AMC, vazhdon të implementohet programi i vizitave shtëpiake për gra shtatëzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare.

Në formë tabelare ju paraqesim vizitat shtëpiake për gra shtatëzëna dhe fëmijë deri në moshën 3 vjeçare për periudhën janar – qershor 2022:

Nr.	Përshkrimi	Totali i vizitave	Shërbime
1.	Vizita për gra shtatëzëna	363	1815
2.	Vizita për fëmijë deri moshën tre vjeç	2203	11015
	Totali	2566	12830

Nga fondi i subvencioneve kemi ndihmuar një numër të konsiderueshëm të rasteve me sëmundje të rënda shëndetësore dhe rasteve sociale, 184 përfitues në shumë prej 41,850.00€;

Kemi subvencionuar 430 përfitues për shtesat për fëmijë, në shumë prej 52,080.00€;

Kemi subvencionuar 62 persona për të prekurit me Covid – 19, në shumë prej 6,500.00€;

Kemi bërë pagesat për qira për 16 familje, në shumë prej 10,000.00€;

Kemi fuqizuar dhe rritur kapacitetet e shërbimit të terrenit për rastet e sëmundjeve kronike, lehonat, si dhe fëmijët deri në moshën 3 vjeç, nga marrëveshja që kemi me Islamic Relief.

Qendra për punë sociale

Asistenca Sociale

Në QPS - Vushtrri, në asistencë sociale janë 1442 familje, prej tyre 1389 familje me 6767 anëtarë janë shqiptarë, si dhe 54 familje me 175 anëtarë janë minoritete.

Gjatë këtij viti janë parashtruar 124 kërkesa për asistencë sociale, prej të cilave 79 janë aprovuar, kurse 45 prej tyre janë refuzuar si familje, të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret, ndërsa janë riaktivizuar 16 familje.

Asistenca sociale i është ndërprerë 72 familjeve, të cilat kanë qenë shfrytëzuese të asistencës sociale.

Në këtë periudhë raportuese kërkesa për ndihma momentale janë 13, prej tyre 2 janë aprovuar në vlerë prej 100 euro dhe 11 të refuzuara.

Gjatë kësaj periudhe në komision mjekësor janë dorëzuar dhe trajtuar 284 aplikantë. Prej tyre janë aprovuar nga KM 233 aplikues, janë refuzuar 36 aplikues, ndërsa në rishqyrtim kanë qenë 13. Nga qeveria janë mbështetur me mjete djegëse (dru) 20 familje me nga 3 m. Pako ushqimore janë 1310, kurse familjet e asistencës sociale janë përkrahur edhe me nga 100 euro mjete materiale.

Shërbimet sociale - Gjatë kësaj periudhe është punuar në trajtimin e rasteve të bashkëshortëve me marrëdhënie të çrregulluara ose në procedurën e shkurorëzimit, fëmijët pa kujdes prindëror, të miturit me sjellje të çrregulluara dhe delikuentë të mitur, viktimat të trafikimit me njerëz, dhuna në familje, kujdesi ndaj personave të moshuar, etj.

Vështirësitë në punë: Numri i pamjaftueshëm i zyrtarëve, mospagesa e zyrtarëve të shërbimeve sociale për punë jashtë orarit (zyrtarë të kujdestarisë), trajnimet shtesë të stafit punues me qëllim të avancimit profesional.

SHËRBIME PUBLIKE

Drejtoria për Shërbime Publike ka bërë përpjekje për të ofruar shërbime sa më cilësore për të gjithë qytetarët e komunës.

Furnizimi me ujë

Sa i përket furnizimit me ujë të pijes, nga marsi i këtij viti, fabrika për prodhimin e ujit në Balincë ka filluar të operojë me orar të plotë 24 h në ditë. Është bërë studimi i fizibilitetit nga komisioni i përbashkët në mes të Komunës së Vushtrrisë dhe Ndërmarrjes KRU „Mitrovica” për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë për vendbanimet e pjesës lindore të komunës. Kemi vazhduar me implementimin e projektit për kyçjen e ekonomive familjare në rrjetin e ujësjellësit, në ç’rast janë kyçur 215 shtëpi, si dhe vendosjen e një numri të konsiderueshëm të ujëmatësve për eliminimin e faturimit paushall. Gjithashtu janë vendosur dy sisteme të pompimit në fshatin Begaj dhe fshatin Smrekonicë për të rregulluar furnizimin e këtyre lokaliteteve me ujë të pijes, ndërsa është në procedurë vendosja e sistemit të pompimit për fshatrat Vilanc, Ropicë dhe Samadrexhë.

Largimi i ujërave të zeza

Në infrastrukturën e rrjetit të kanalizimit gjatë vitit 2022 nuk janë bërë investime, për shkak se dy Operatorë ekonomik të cilët posedojnë kontratat dyvjeçare, kanë refuzuar të vazhdojnë realizimin e tyre për shkak të ngritjes enorme të çmimeve si rezultat i pandemisë, prandaj jemi në procedurë të shkëputjes së këtyre kontratave dhe inicimit të procedurave të reja, ndërsa është bërë zhblokimi i një numri të konsiderueshëm të gypave dhe pusetave të bllokuar.

Largimi i ujërave atmosferike

Në kuadër të planit të punës së drejtorisë, me planin financiar është paraparë që të intervenohet në pastrimin e pusetave të kanalizimit atmosferik. Gjatë kësaj periudhe është bërë pastrimi i ujëmbledhësve të prrockave dhe rrjedhave të ujit në qytet, përmes kontratës me Ndërmarrjen “UNITETI”.

Menaxhimi i mbeturinave

Në fushën e menaxhimit të mbeturinave, Drejtoria për Shërbime Publike, me qëllim të krijimit të një ambienti të pastër dhe të shëndoshë, ka bërë rishikimin e planit pesëvjeçar për menaxhimin e mbeturinave brenda territorit të Komunës së Vushtrrisë 2022-2026, i cili plan është miratuar në seancën e muajit shkurt të këtij viti. Si rezultat i këtyre angazhimeve, Komuna e Vushtrrisë është duke bërë ofrimin e shërbimit për të gjitha vendbanimet e komunës. Gjithashtu është duke u bërë grumbullimi i ndarë i mbeturinave të rreth 1500 ekonomive familjare, të cilat janë duke u paketuar në qendrën për paketim në Bukosh. Në garat për “Mjedis të Pastër” Komuna e Vushtrrisë nga viti 2016 i ka plotësuar kriteret e qasjes ndaj fondeve të Qeverisë Gjermane dhe Bashkimit Evropian dhe ka përfituar mjete të konsiderueshme nga GIZ-i, të cilat janë konventuar në dy kompaktorë 8 m³ dhe një kompaktor 16 m³ me të cilët jemi furnizuar më datë 23.6.2022. Po ashtu është bërë eliminimi i qëndrueshëm i deponive ilegale si deponia në fshatin Banjskëj dhe aktualisht i kemi vetëm gjashtë deponi të tilla. Si rezultat i këtij angazhimi, Ndërmarrjes „UNITETI” i është siguruar një stabilitet financiar dhe kemi arritur që në masë të madhe ta përmirësojmë gjendjen e ambientit. Është ky viti i dytë prej themelimit të Ndërmarrjes

lokale „Përparimi”, përmes së cilës janë ofruar shërbimet e sigurimit dhe pastrimit të objekteve, është bërë mbjellja e rreth 25 000 luleve dekorative, si dhe mirëmbajtja e hapësirave publike. Gjatë kësaj periudhe është bërë hartimi dhe dorëzimi në AMM - Raporti për menaxhimin e mbeturinave për vitin 2021 dhe gjithashtu është hartuar dhe dorëzuar në MAPL Raporti i Sistemit për Menaxhim të Performancës në Ofrimin e Shërbimeve Komunale për Vitin 2021.

Ndriçimi publik

Ka vazhduar implementimi i kontratës për mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik, si dhe është zhvilluar procedura e re për mirëmbajtje të ndriçimit e cila është në fazën e vlerësimit.

Komunikacioni

Në kuadër të fushës së trafikut, është menaxhuar kontrata për shërbimet e transportit me automerimangë, janë nxjerrë vendime për bllokim të shiritave rrugor dhe vendime për shfrytëzim të parkingjeve nga operatorët e transportit të udhëtarëve me Radio-taksi, vendime për ndaljen e mjeteve motorike për ngarkim - shkarkim.

Në fushën e trafikut ka vazhduar implementimi i kontratës për furnizim dhe vendosje të sinjalizimit horizontal dhe vertikal në rrugët e qytetit, me qëllim të krijimit të një rrjeti funksional dhe të integruar, duke synuar rritjen e shkallës së sigurisë për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, pra krijimin e kushteve për lëvizje të motorizuara dhe të pamotorizuara, duke përfshirë edhe personat me nevoja të veçanta, ndërsa jemi në përpjekje që së bashku me UN – HABITAT të bëjmë hartimin e planit të mobilitetit.

Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, ka vazhduar mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara përmes kontratës për rikonstruim dhe mirëmbajtje të rrugëve, në ç’rast janë riparuar mjaft segmente rrugore me asfalt dhe me kubëza si: rruga “2 Maji”, rruga në fshatin Dumnicë e Epërme ku është hapur pishina rekreative Atlantis, rruga në fshatin Smrekonicë, rr. „Lumni Surdulli”, rruga në fshatin Begaj, pastaj rregullimi i një numri të konsiderueshëm të pusetave dhe ndërrim të gypave të kanalizimit në fshatin Maxhunaj, Bukosh, etj. Gjithashtu është në përfundim kontrata për mirëmbajtjen e rrugëve me zhavorr, në ç’rast janë trajtuar një numër i konsiderueshëm i rrugëve të rendit të IV.

URBANIZËM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria e Urbanizimit e Komunës së Vushtrrisë ka vazhduar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për trajtimin e kërkesave në kuadër të: Sektorit të urbanizimit, planifikimit, legalizimit, mjedisit dhe Zyrës së adresave si dhe shërbimet juridike.

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2022, kryesisht janë mbajtur takime të organizuara nga sektori i planifikimit urban për çështjet e rregullimit urban, pjesëmarrja në konferenca të organizuara nga niveli qendror dhe grupe tjera ndërkombëtare, takimet e rregullta etj.

DUMM është në partneritet që nga viti 2019 me UN Habitat Kosova në hartimin e Hartës Zonale për Komunën e Vushtrrisë, ndërkaq drafti final është në përfundim e sipër.

Sektori i urbanizmit

Është marrë me shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me kushtet e lokacionit, lejeve ndërtimore, lejeve paraprahe, leje për rrënimin e objekteve, leje përdorimi të objekteve, informacione për destinimin e sipërfaqeve nga planet përkatëse rregulluese, duke kaluar nëpërmes procesit të daljes në terren dhe incizimit të gjendjes faktike në terren ku përmes sektorit për planifikim urban e ka vazhduar procesin e mëtutjeshëm për finalizim, kurse janë kryer këto punë:

Lejet ndërtimore:

- Vendime për leje ndërtimore.....6;
- Për objekte të kategorisë II - 6 leje ndërtimore;
- Refuzime 1;
- Në procedurë 1.

Ju janë aprovuar kërkesat kompanive si KEDS, IPKO, për shtrirjen e rrjetit nëntokësor vendosjen e ormanëve MDF.

Sektori për planifikim urban

Gjatë periudhës gjashtëmujorë është bërë sistematizimi i lëndëve të ndryshme, koordinimi profesional dhe ligjor brenda drejtorisë, zbatimi i Planit zhvillimor komunal, kontrollimi i rregullt i projekteve kapitale, zgjidhje dhe përgjigje të kërkesave të qytetarëve, përgatitja e projekteve konkurruese ideore, vizitat e punimeve në terren-mbikëqyrja e projekteve, monitorimi dhe aprovimi për kushte dhe leje ndërtimore, pranime teknike të disa projekteve, mbajtja e disa seminareve të organizuara nga organizata të ndryshme, takimet me grupet punuese, me UN-Habitat për punimin e Hartës Zonale.

Kushte ndërtimore:

- Vendim për caktimin e kushte ndërtimore.....3;
- Për objekte të kategorisë I - 1 kushte ndërtimore;
- Për objekte të kategorisë II - 2 kushte ndërtimore.

Në bashkëpunim me UN-Habitat është punuar në:

Hartimi i raportit të vlerësimit lokal për lokalizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Sektori për mbrojtje të mjedisit

Drejtoria ballafaqohet me një numër mjaft të vogël të stafit e cila e bënë të pamundur zbatimin sa më efikas të detyrave dhe përgjegjësi, përkatësisht në sektorin e mbrojtjes së mjedisit ku jemi vetëm me një zyrtar të vetëm.

Në respektim të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Udhëzimit administrativ për dhënien e lejeve mjedisore komunale, kemi lëshuar dhe shqyrtuar me kërkesën e palëve 8 kërkesa për leje mjedisore komunale.

Vendime për leje mjedisore komunale.....8

Sektori i legalizimit

-Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar gjithsej 152 kërkesa, si në vijim:	
-Vendime për legalizim.....	17;
Kategori I.....	15;
Kategori II.....	2;
-Plotësim dokumentacioni.....	0;
-Lista e pritjes.	0;
-Informim për taksë	0;
-Dërgesë dokumentacioni - dorëzim palës.....	7.

Sfidat e drejtorisë

Si sfidë kryesore e drejtorisë në realizimin e qëllimeve dhe objektivave është mungesa e stafit në numër, dhe në aspektin e përgatitjes profesionale. Si sfidë e të ardhmes mbetet angazhimi i të gjithë stafit për respektimin e afatit të përcaktuar ligjor, për përfundimin e kërkesave të palëve, e po ashtu sfidë tjetër mbetet gjetja e metodave për vetëdijesim të qytetarëve që të pajisen me leje përdorimi-certifikatë të përdorimit për ndërtesat që paraprakisht janë pajisur me leje ndërtimi, si dhe për legalizimin e ndërtimeve pa leje. Synimi i drejtorisë është gjithashtu dhe realizimi me sukses i të gjithë projekteve për investimet kapitale të buxhetuara në kuadër të drejtorisë.

KULTURË, RINI, SPORT

QENDRA E KULTURËS

Gjatë këtij gjashtëmujori, Qendra e kulturës ka organizuar apo ka mbështetur në organizim të gjitha aktivitetet kulturore që janë organizuar nga institucionet komunale. Po ashtu, ka ndihmuar në organizimin e aktiviteteve të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së dhe aktiviteteve të ndryshme në të cilat është kërkuar ndihma jonë. Ndër aktivitetet kulturore që janë organizuar nën patronazhin e Kryetarit të Komunës së Vushtrrisë, përkatësisht nga Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, në të cilat Qendra e kulturës ka organizuar aktivitetin apo ka marrë pjesë në aktivitete, veçojmë:

Organizimi i ceremonisë për shpalljen e Sportistëve të vitit 2021, më 28 janar 2022;

Promovimi i librit “Vicianë – Vushtrria I”, nga autori Izet Miftari, 15 shkurt 2022;

Hapja e ekspozitës me punime prej letre <ORIGAMI>, nga Hadije Zuçaku, 15 shkurt 2022;

Promovimi i librit “Syzheu i jetës”, nga Arxhela Krasniqi, 25 shkurt 2022;

Akademi solemne për nder të “Ditës të Pavarësisë të Republikës së Kosovës”, 17 shkurt 2022;

Aktiviteti “Mësuesi i lirisë”, në kuadër të Epopesë së UÇK-së, 7 mars 2022;

Aktiviteti “Këpucët e kuqe”, kushtuar grave që kanë humbur jetën si pasojë e dhunës, 8.3.2022;

Akademi përkujtimore për prof. Fahri Buçinca, më 18 mars 2022;

Ekspozitë me fotografi „Fshatrat e Vushtrrisë“, të autorit Berat Mernica, 25 mars 2022;
 Përrurimi i librave „Njeriu i lartësive“, të autorit Gëzim Saraçi dhe „Dhe unë jam njeri“, të autorit Lulëzim Krasniqi – Arbanasi, 1 prill 2022, i cili ndonëse është mbajtur në Prishtinë është organizuar nga Komuna e Vushtrrisë;
 Akademi përkujtimore dhe zbulimi i lapidarit të dëshmorit Blerim Agim Saraçi, 2 prill 2022;
 Shfaqja „Akraballëkët“, në regji të Fazli Muharremit, 9 prill 2022;
 Akademi përkujtimore dhe zbulim i lapidarit të dëshmorit Avni Hajdin Klinaku, 18 prill 2022;
 Akademi përkujtimore „Studimja 99“, më 2 maj 2022;
 Homazhe për nder të përkujtimit të Masakrës së 22 Majit në Vushtrri, më 22 maj 2022;
 Koncert „Kultura na bashkon“, në bashkëpunim me AKV „Mirdita“, nga Mirdita e Shqipërisë;
 Fillimi i kursit të artit figurativ, i cili po zhvillohet në atelienë e Qendrës së kulturës, nga data 30 maj 2022 dhe po vazhdon akoma;
 Akademi përkujtimore për masakrën mbi familjen Gërxhaliu, 31 maj 2022;
 Aktivitete dhe koncert për fëmijë për nder të „Ditës së Fëmijëve - 1 Qershori“ 2022;
 Akademi solemne për nder të „Ditës së Çlirimit të Vushtrrisë“, 17 qershor 2022;
 Koncert me grupin muzikor “TNT”, në sheshin “Adem Jashari”, më 17 qershor 2022;
 Përrurimi i librit “Mos ma vjedh lirinë”, të autorit Burim Gjaka, 16 qershor 2022.

Ndër aktivitetet e veçanta që vlen të raportohet është edhe organizimi i festivalit “Takimet e Poeteshave Shqiptare”, edicioni i 40-të, për të cilin kanë filluar parapërgatitjet rreth shpalljes së konkursit letrar, që do të publikohet gjatë ditëve në vazhdim.

BIBLIOTEKA

Në sektorin për fëmijë janë dhënë për lexim 2138 libra;
 Në sektorin për të rritur janë dhënë për lexim 1953 libra;
 Sallën e leximit e kanë shfrytëzuar 947 lexues;
 Janë përpunuar 430 libra;
 Lexues të regjistruar në sektorin për të rritur 37 vetë;
 Lexues të regjistruar në sektorin për fëmijë ishin 58;
 Në dy sektorët janë të regjistruar 95 lexues, derisa janë dhënë për lexim 4091 libra.

MUZEU

Në këtë sektor është punuar në pasurimin e muzeut me eksponate në fushën e etnologjisë, folklorit, pasurimin e kinotekës dhe fototekës, pasurimin e bibliotekës, shkencore të muzeut, etj.

Arkivi historik i qytetit-Vushtrri

Shërbimi për mbrojtjen e dokumenteve arkivore jashtë arkivit	<ul style="list-style-type: none">Kemi pasur bashkëpunim profesional edhe me Arkivin ndërkomunal të Mitrovicës në lidhje me regjistratorët jashtë arkivit.
Pranimi i lëndës arkivore nga institucionet locale	Në këtë periudhë kohore kemi pranuar material të ndryshëm nga Drejtoria e Kadastrit, materiali i dorëzuar pasi ka dalë jashtë funksionit të resorit iu ka dorëzuar arkivit komunal.

TEATRI

Më 13 janar 2022 në teatrin e Vushtrrisë u shfaq komedia “Mat” në regji të Ben Apollonit në interpretim të Brahim Bashes dhe Blerina Veselit, kurse autor ishte Ag Apolloni.

Më 10 shkurt kemi filluar përgatitjet e para me aktorë të komedisë "Akraballakët" autor Kristo Floqi në regji të Fazli Muharremit dhe më 9 prill u dha premiera e kësaj komedie.

Më 16 prill u reprizua kjo komedi dhe interesimi ishte shumë i madh dhe pas dy jave kjo komedi u shfaq për nxënësit e dy shkollave SHMU- 1 dhe nxënësve të shkollës së Akrashticës.

Më 16 qershor u organizua promovimi i librit “Mos ma vrit lirinë”, ku teatri e mori organizimin e këtij promovimi dhe interpretuan edhe tre aktorët e qytetit, sikurse në organizimin e promovimit të librit „Të prita tek Ura e Gurit“, në ç’rast teatri ishte në organizim dhe interpretim.

SPORTI

Për nder të Pavarsisë, më 17 Shkurt, Drejtoria për Kulturë ka përgaditur një sërë aktivitete sportive. Gara në basketboll, volejball.

Federata e tenisit ka mbajtur tubim me 300 fëmijë nga e gjithë Kosova, duke organizuar gara në këtë sport.

Më datat 5, 6, 7 mars, janë zhvilluar aktivitete sportive, gara në shah, basketboll, futboll etj.

Më datë 8 mars janë zhvilluar gara në hendboll dhe volejball për shënimin e „Ditës së Gruas“.

Federata e basketbollit ka paraqitur aktivitetin shumë të rëndësishëm NBA Junior League dhe ka përzgjedhur komunën tonë për ta promovuar këtë ligë mjaft interesante për fëmijët e moshave 10 deri në 14 vjeç, ku talentja nga Vushtrria MALVINA Haziri ka vazhduar këtë aktivitet edhe në shtetin e Italisë, pastaj për ta vazhduar në Turqi dhe Amerikë.

Organizimi nga Federata e ping – pongut, garat me fëmijë nga mosha 15 deri në 20 vjeç. Janë zhvilluar edhe ndeshjet e garave në Play off.

Ndeshjet finale të garave republikane janë zhvilluar në Komunën e Vushtrrisë falë bashkëpunimit të mirë me Shoqatën e profesorëve të edukatës fizike.

Janë zhvilluar aktivitete në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës, <Java e sportit> ku kemi zhvilluar gara në atletikë dhe në gjimnastikë.

Organizimi i ndeshjeve finale të Ligës Junior NBA League. Pjesëmarrëse ishin 6 komuna nga Kosova.

Shënimi i ditës 17 Qershori – “Dita e Çlirimit të Vushtrrisë” turneru në futboll me veteranët e Vushtrrisë dhe veteranët e UÇK-së.

Shënimi i ditës së 26 qershorit - Turneu në ping – pong.
Shënimi i Ditës Olimpikë të Kosovës, organizuar gara në striboll.

RINIA

Takime pune dhe informues me përfaqësuesit e OJQ- ve rinore. Gjatë takimeve me ta është bërë planifikimi, janë hartuar projekt-propozime dha janë dërguar për mbështetje në MKRS dhe USAID-ATRC, OSCE dhe organizata tjera.

Takime pune dhe bashkëpunim me OSCE, me Qendrën Rinore “Hareja”, Organizatën Rinore “Aces”, KVRL-në, Punë dhe takime të ndryshme me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve rinore. Është në realizim e sipër projekti “Komuna për të rinj”. Ky projekt realizohet nga Komuna e Vushtrrisë në bashkëpunim me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Bankën Botërore, si dhe organizatën facilituese CDF. Ky projekt do të ketë një impakt të mirë për zhvillimin e aktiviteteve rinore, pasi që shumata totale për mbështetjen e të rinjve në total arrin vlerën 250.000.00 dollarë amerikan.

GJEODEZI DHE KADASTËR

Gjatë periudhës 1.1.2022-30.6.2022, në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, janë kryer këto punë dhe detyra të punës:

Nr. rend.	LËNDËT E ARRITURA janar- qershor 2021	Gjithsej
1.	KËRKESAT E PRANUARA	4564
2	AKTVENDIME PËR BARTJE	860
3.	AKT. PËR KORRIGJIMIN E EMRAVE DHE MBIEMRAVE	86
4.	AKTVENDIME PËR REGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	81
5.	AKTVENDIME PËR ÇREGJISTRIMIN E HIPOTEKAVE	43
6.	VËRTETIME-CERTIFIKATA	240
7.	NDARJE, BASHKIM I PARCELAVE, KOORDINATA	280
8.	INCIZIMI I GJENDJES FAKTIKE	12
9.	UZURPIMET	//
10.	KOPJE TË PLANIT	410
11.	LISTA POSEDUESE	1561
12.	KËRKESA ZYRTARE TË NDRYSHME	68
13.	SHPRONËSIME	//
14.	LËNDËT NË PROCEDURË	42
15	Kërkesa tjera (identifikim, dalje në terren, ankesa etj).	92

Gjatë periudhës raportuese, zyrtarët e drejtorisë kanë kryer punë të ndryshme për nevoja të komunës, gjegjësisht të drejtorive tjera gjatë realizimit të projekteve të ndryshme (asfaltim të rrugëve, rregullim të trotuareve, lirim të hapësirave publike etj.).

Përkundër punëve dhe detyrave të punës, të kryera në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, ballafaqohet me një sërë problemesh të natyrës

objektive dhe subjektive, si: mungesa e elaborateve kadastrale, të cilat janë plaçkitur nga okupatori serb në vitin 1999; problemet e trashëguara të natyrës pasurore-juridike, si uzurpimet, kontestet e bartura nga komasacioni etj.

MBROJTJE DHE SHPËTIM

Gjatë periudhës janar-qershor 2022, në DMSH ka pasur angazhime të rregullta, por edhe raste emergjente, veçanërisht me vërsime ku edhe kemi intervenuar me kompaninë e kontraktuar për angazhim në situata emergjente në terren për eliminimin e disa pikave kritike. Kemi pasur takime me pjesëtarë të FSK-së, AME-së me policinë e Kosovës - stacioni në Vushtrri, KFOR-in , Kryqin e Kuq në Vushtrri, QOR 112.

Në muajin qershor, konkretisht më 8.6.2022 dhe 20.6.2022 Komuna e Vushtrrisë u përfshi nga një stuhi me shi të dendur dhe shtrëngata e vende vende edhe të shoqëruara me breshër, kështu që më të dëmtuar ishin fshatrat: Stroc, Bivolak, Beçuk, Gllavatini në pjesën jugperëndimore, si dhe Kunoviku, Cecelia, Sllakoci, Vesekoci dhe Kurillova nga pjesa verilindore e qytetit të Vushtrrisë. Në këtë rast disa ekonomive familjare dhe fermerëve të këtyre lokaliteteve ju janë shkaktuar dëme të konsideruara materiale.

Në bazë të kërkesës së parashtruar nga të dëmtuarit, Komisioni komunal për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, kanë dalë në terren dhe kanë bërë vlerësimin profesional të dëmeve.

Në bazë të ekzaminimit dhe vlerësimit nga ana e komisionit, vlera e përgjithëshme e dëmeve të shkaktuara nga këto fatkeqësi vlerësohet të jetë **52.714.17** euro.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore qytetarët kanë pasur vështirësi sa i përket furnizimit me ujë teknik dhe ujë kanë kërkuar 47 familje.

Problemet dhe vështirësitë:

- Mungesa e stafit
- Kërkesat e mëdha dhe të njëpasnjëshme të qytetarëve për intervenim.
- Mosbindja e disa qytetarëve për të vepruar në terren konform planit për veprim emergjent.
- Mungesa e mjeteve adekuate për punë.
- Mungesa e veshmbathjes mbrojtëse dhe dalluese për zyrtarët e DMSH-së.

AKTIVITETET E NJPZSH-së GJATË PERIUDHËS

Realizimi i numrit të përgjithshëm të daljeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera viti 2022

2022	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i Zjarreve	Nr. i teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidante rrugore	Vërshime	Të rrejshme	Të lënduar			Të vdekur			Githsej
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot	
Janar	30	13	4	13		44								
Shkurt	32	18	3	10		3	1							
Mars	65	45	3	16										
Prill	37	21	3	13			1							
Maj	30	14	5	11			1							
Qershor	43	30	5	8		1								
Gjithsej	237	141	23	71		48	3							

INSPEKTIMET

Sektori i inspektoratit	Numri i Inspektorëve	Procesverbale	Fletparaqitje	Aktivendime/Urdhëresa	Mbyllje të lokaleve përkohësisht	Gjoha mandatore
Inspektorët e tregut	4	224	-	55	2	6
Inspektorët e ndërtimtarisë	1	32	4	13		2
Inspektorët e komunikacionit	1	37	-	21		-
Inspektorja e higjienës	1	14	-	73	-	2
Totali	7	307	4	162	2	10

Aktivitetet e paraqitura në mënyrë tabelare

Subjektet afariste të pajisura me pëlqim për plotësimin e kushteve minimale teknike për objektet e shitjes me pakicë dhe shumicë. Bartës të aktivitetit inspektorati i tregut

APLIKUAR	54
TË VENDOSURA	50
TË REFUZUARA	4
MJETE TË INKASUARA	2400.00 €

Pranimi teknik i automjeteve. Bartës të aktivitetit inspektorati i komunikacionit

APLIKUAR	21
TË VENDOSURA	21
MJETE TË INKASUARA NË €	105,00 €

Malli i larguar nga shitja dhe qarkullimi, si dhe mall i asgjësuar nga inspektorati i tregut dhe sanitar

Mall i asgjësuar	8975,43 kg
------------------	------------

Mjete të inkasuara nga malli i asgjësuar

Mall i asgjësuar	3 x 150.00	450.00 €
------------------	------------	----------

Gjopa të aplikuara nga inspektorati

APLIKUAR	10
TË VENDOSURA	10
MJETE TË INKASUARA NË €	1150,00 €

Nr.	PËRSHKRIMI I AKTIVITETIT	SASIA	VLERA
1	AKTIVITETE INSPEKTUESE	288	

2	PROCESVERBALE	307	
3	AKTVENDIME/ URDHËRESA TË NDRYSHME	162	
4	FLETPARAQITJE NË GJYKATË	4	
5	PRANIME TEKNIKE	54	2400.00 €
6	PRANIME TEKNIKE TË AUTOMJETEVE	21	105.00€
7	MALL I LARGUAR NGA SHITJA DHE ASGJËSIMI I MALLIT	8975,43 kg	
8	PAGESË PËR ASGJËSIM TË MALLRAVE	3	450.00 €
9	KËRKESA TË PRANUARA	265	
10	KËRKESA TË MIRATUARA	249	
11	KËRKESA TË REFUZUARA	9	
12	KËRKESA TË HEDHURA POSHTË	7	
13	DËNIME MANDATORE	10	1150.00 €
14	MBYLLJE TË PËRKOHSHME TË LOKALEVE AFARISTE	3	

Nga ana e inspektorëve është mbajtur kujdestari jashtë orarit të punës për ditët e vikendeve dhe të festave, me qëllim të inspektimit nga të gjitha lëmitë që i përkasin Drejtorisë për Inspektime.

Përfundim:

Ky raport paraqet punët që janë kryer nga ekzekutivi i komunës në këtë gjashtëmuor. Nga muaji qershor deri në ditën kur po paraqitet ky raport janë kryer edhe punë tjera të shumta, të cilat do të përfshihen në raportin vjetor 2022.



Erin Idrizi

Kryetar i Komunës